



Nëpërmjet një deklarate për shtyp, Policia e Tiranës ka sqaruar të gjithë situatën e krijuar një ditë më parë në shkallët e stadiumit “Qemal Stafa”, në përballjen mes Tiranës dhe Skënderbeut të Korçës. Policia tha se ka shoqëruar 11 persona, të cilët sipas saj, mbanin me vete sende të ndaluara ku është evidentuar se gjatë pjesës së parë të ndeshjes janë hedhur lëndë piroteknike, fishekzjarre e tymuese, të cilat kanë krijuar probleme për rendin publik në stadium. “Jane konstatuar veprime e xheste antisportive, jane bllokuar sende e mjete te kundraligjshme, per pasoje jane shoqeruar edhe personat pergjegjes ne Komisarjatin e Policise, te cilet perbenin rrezik edhe per konfrontimin mes dy tifozerive.”- thuhet më tej në deklaratën e Policisë. Në cilësinë e provës materiale policia ka sekuestruar një doreze metalike, një thike, 29-fishekzjarre të bashuara në kallepe tërës dhe gjashtëshe gati për të hedhur në fushë, janë bllokuar 2 tymuese-lotuese etj, që sipas policisë janë të ndaluara dhe mund të sjellin pasoja për jetën e njerëzve dhe rendin në stadium. Ndërkaq, policia ka nisur procedim penal ndaj një shtetasi, A.D, 19 vjeç, të cilit i është gjetur dhe sekuestruar një thike dhe një doreze metalike.